

**VENDIM**  
**Nr. 836, datë 26.12.2024**

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE NË BASHKITË KAMZË, MIRDITË, SHIJAK DHE KRUIJË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nëndarja “i”, 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 97, datë 7.12.2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 621 985 790,80 (gjashtëqind e njëzet e një milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë presje tetëdhjetë) lekë pa TVSH, për financimin e riforcimit të banesave individuale në bashkitë Kamzë, Mirditë, Shijak dhe Krujë, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Kamzë, në masën 42 100 570 (dyzet e dy milionë e njëqind mijë e pesëqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH;

b) Bashkisë Mirditë, në masën 17 108 695 (shtatëmbëdhjetë milionë e njëqind e tetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH;

c) Bashkisë Shijak, në masën 182 321 595 (njëqind e tetëdhjetë e dy milionë e treqind e njëzet e një mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH;

ç) Bashkisë Krujë, në masën 380 454 930,80 (treqind e tetëdhjetë milionë e katërqind e pesëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e tridhjetë presje tetëdhjetë) lekë pa TVSH.

2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2024, nga bashkitë Kamzë, Mirditë, Shijak dhe Krujë, në masën 549 057 152,80 (pesëqind e dyzet e nëntë milionë e pesëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e pesëdhjetë e dy presje tetëdhjetë) lekë pa TVSH, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Kamzë, në masën 42 100 570 (dyzet e dy milionë e njëqind mijë e pesëqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH;

b) Bashkisë Mirditë, në masën 17 108 695 (shtatëmbëdhjetë milionë e njëqind e tetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH;

c) Bashkisë Shijak, në masën 109 392 957 (njëqind e nëntë milionë e treqind e nëntëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH;

ç) Bashkisë Krujë, në masën 380 454 930,80 (treqind e tetëdhjetë milionë e katërqind e pesëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e tridhjetë presje tetëdhjetë) lekë pa TVSH.

3. Efekti financiar do të përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024, dhe u transferohet bashkive Kamzë, Mirditë, Shijak dhe Krujë në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e riforcimit të banesave individuale për ata individë, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë, që rezultojnë me shkallë dëmi DS4 e që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni, në bazë të aktekspertizave të thelluara.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe bashkitë Kamzë, Mirditë, Shijak dhe Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
**Edi Rama**